

VENDIM
Nr.80, datë 26.1.2011

PËR RIKONSTRUKSIONIN E PLOTË TË GODINËS SË AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË UASHINGTON

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 11 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, që me fondet e saj të kryejë rikonstruksionin e plotë të godinës së Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, në Uashington, pronë e shtetit shqiptar.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme të nxjerrë udhëzimin përkatës për rregullat e prokurimit, që do të zbatohen për këtë procedurë prokurimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha